



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KONTRATA

Në mes të

Komuna e Lipjanit – Zyra e Prokurimit (në tekstin e mëtejme Autoriteti Kontraktues)

Dhe

" Dezinfektimi AD " SH.P.K. përfaqësuar nga **Arbana Munishi** me numër të regjistrimit të biznesit. **810186644** në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin këtë kontratë:

Titulli: Furnizimi me kabine për dezinfektim dhe mirëmbajtja e saj për 3 muaj

me nr. të prokurimit **613 020 018 135**

Duke u bazuar në kërkesën e DSHPS-se për furnizim me kabine për dezinfektues për parandalimin e Covid 19 e cila do të vendoset në hapsirë të QKMF-se në Lipjan

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontraktuesi do të furnizojë me kabine për dezinfektim dhe furnizimi me material dezinfektues për 3 muaj. Si në tabelën më poshtë

Furnizimi me Kabine me dimensione L= 200 x B=120 x H=240					
KABINA 1					
nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Qmimi	Totali
1	Furnizimi me Kabine me dimensione L= 200 x B=120 x H=240 kabina duhet të jetë prej konstruksionit metalik apo alumin i mveshur me xham të plastifikuar në dy anet edhe mbulesa duhet të jetë e njëjtë (xhami të jetë me folie në mes që të jetë rezistent në rast goditjeve) të llogariten edhe aksesoret shtesë për funksionalizim të kabines për dezinfektim	Cope	1	1830	1830.00
2	Furnizimi me material Dezinfektues	Muaj	3	50	150.00
Totali				1980	

KABINA 2					
nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Qmimi	Totali

1	Furnizimi me Kabine me dimensione L= 200 x B=120 x H=240 kabina duhet te jete prej konstruksionit metalik apo alumin i mveshur me xham te plastifikuar ne dy anet edhe mbulesa duhet te jete e njejt (xhami te jete me folie ne mes qe te jete rezistend ne rast goditjeve) te llogariten edhe aksesoret shtese per funksionalizim te kabines per dezinfektim	Cope	1	1830	1830.00
2	Furnizimi me material Dezinfektues	Muaj	3	50	150.00
	shuma				1980.00

						Totali tyabl+tabela 2	3960.00
--	--	--	--	--	--	-----------------------	---------

2. Vendi i dorëzimit

Kontraktuesi do të furnizojë me kabine per dezinfektim sipas kerkeses se menagjerit dhe nevojës se paraqitur

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 14/04/2019 dhe vazhdon furnizimi me material dezinfektues per kabin per 3 muaj

1.3 Afati kohor i për montimin e kabinës 1 nuk mund të jetë me tepër se 1ditë nga data e marrjes së urdhërësës. Fillimi i kryerjes së furnizimeve sipas marrëveshjes me drejtuesit e objekteve që janë specifikuar përfundim jo më largë se 1 ditë pas nënshkrimit të kontratës

1.4 kontraktuesi do të furnizojë me kabinën nga tabela 1 brenda 1 dite ndërsa për kabinën nga tabela dy do të vendoset kur do të furnizohemi , pagesa do të kryhet vetëm për kabinën që furnizohemi dhe shërbimet e kryera. Furnizimi me dezinfektues për 3 muaj.

2 Çmimi

Çmimi i furnizimeve sipas kontratës me procedurë të negociuar është gjithsej: 3960.00 apo shprehur me fjalë trenijë e nëntëqind e gjashtëdhjet euro sipas përshkrimeve të sasive të dhëna ne Dosjen e tenderit nr. 613-020-018-135 .

3. Neni 4 Pagesat

Pagesa do të bëhet në Euro. Pas përfundimit të furnizimeve dha hartimit të raporti nga komisioni për pranim të mallit.

Pagesa do të kryhet vetëm për kabinën që furnizohemi dhe shërbimet e kryera.

Faturat do të krijohen sipas zotimit të mjeteve , për hartim te faturave kontraktuesi do të konsultohet me menagjerët e kontratës.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë]

Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

Kualiteti mallrave të furnizuar duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

Autoriteti kontraktues do të inspektojë, kontrollojë, mallrat e furnizuara në momentin e pranimit të artikujve us qimor dhe materialit higjenik të dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse mallrat e furnizuara kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

4. Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

5. 11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Falimenton; e). f). Është dënua nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 80 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Arbana Munishi	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	PULLTOR	Pozita:	Drejtor i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.04.2020	Data:	14.04.2020
Vula:		Vula:	

Furnizimi me Kabine me dimensione L= 200 x B=120 x H=240					
KABINA 1					
nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Qmimi	Totali
1	Furnizimi me Kabine me dimensione L= 200 x B=120 x H=240 kabina duhet te jete prej konstruksionit metalik apo alumin i mveshur me xham te plastifikuar ne dy anet edhe mbulesa duhet te jete e njejt (xhami te jete me folie ne mes qe te jete rezistend ne rast goditjeve) te llogariten edhe aksesoret shtese per funksionalizim te kabines per dezinfektim	Cope	1	€ 1,830.00	€ 1,830.00
2	Furnizimi me material Dezinfektues	Muaj	3	€ 50.00	€ 150.00
Totali				€	1,980.00

KABINA 2					
nr	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Qmimi	Totali
1	Furnizimi me Kabine me dimensione L= 200 x B=120 x H=240 kabina duhet te jete prej konstruksionit metalik apo alumin i mveshur me xham te plastifikuar ne dy anet edhe mbulesa duhet te jete e njejt (xhami te jete me folie ne mes qe te jete rezistend ne rast goditjeve) te llogariten edhe aksesoret shtese per funksionalizim te kabines per dezinfektim	Cope	1	1830	€ 1,830.00
2	Furnizimi me material Dezinfektues	Muaj	3	50	€ 150.00

Totali	€	1,980.00
--------	---	----------

RIKAPITULLIM		
KABINA1	€	1,980.00
KABINA2	€	1,980.00
TOTALI	€	3,960.00

